



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.273-2/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Kymete Kicaj, kryesuese, Arsim Hamzaj dhe Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Gentiana Bajrami Atashi, kandidate për anëtare të kuvendit komunal në Komunën e Pejës, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega Pejë, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 30.10.2025, merr këtë,

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa, ZL. Anr.273/2025 e datës 19.10.2025, parashtruar nga Gentiana Bajrami Atashi, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Pejës, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega Pejë, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Më datë 19.10.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesë nga Gentiana Bajrami Atashi, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Pejës, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega Pejë, në të cilën thekson se ka mospërputhje të rezultateve të numrit të votave të publikuara me numrin real të votave të konfirmuara nga dëshmitarët në teren. Parashtruesja e ankesës dyshon për parregullsi gjatë numërimit të votave nga QNR, veçanërisht në klasat: 1702/01, 1701/02, 1705/01, 1706/06, 1706/07, 1707/01, 1705/01, 1712/01, 1714/01, 1715/01, 1722/01, 1722/02, 1722/03, 1725/05, 1726/01. E njëjta kërkon verifikim dhe hapje të kutive për saktësi në këto qendra të votimit.

KQZ në përgjigjen në ankesë lidhur me pretendimet e palës ankuese sqaron se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen

në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN).

Andaj, bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet e Zgjedhore nenin 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilit do VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV, Rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimueshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre. Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, pala mund të ushtrojnë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP. Sa i përket pretendimeve të palëve ankuese që mbështeten në deklaratimet e personave, duhet theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit. Lidhur me pretendimet e palës ankuese për mospërputhje të rezultatit zgjedhor, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese, nuk ka bashkëngjitur prova relevante që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e mospërputhjes së rezultateve zgjedhore.

PZAP, pas shqyrtimit të kësaj ankesë, me vendimin ZL. Anr.273/2025 e datës 22.10.2025, ka refuzuar të pabazuar ankesën e parashtruar nga Gentiana Bajrami Atashi, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega Pejë.

Në procedurë ankimore, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin A.A.nr.98/2025 të datës 24.10.2021, ka aprovuar ankesën e Gentiana Bajrami Atashi, kandidate për anëtare të kuvendit komunal në Komunën e Pejës, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega Pejë dhe ka anuluar vendimin e PZAP-it ZL.A.nr.273/2025 të datës 22.10.2025, dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje në PZAP.

Me rastin e rivendosjes sipas ankesës së lartë përmendur të Gentiana Bajrami Atashi, duke vepruar në tërësi sipas vërejtjeve të dhëna nga Gjykata Supreme e Kosovës në Aktvendimin A.A.nr.98/2025 të datës 24.10.2025, dhe me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në këtë procedurë të rivendosjes, Paneli i mbledhi, analizoi dhe vlerësoi të gjitha provat nga shkresat e lëndës, dhe nga tërësia e shkresave, provave dhe dëshmive është konkluduar se:

- Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, përgjigjes në ankesë të KQZ-së, vlerësoj se pretendimet në ankesën e Gentiana Bajrami Atashi, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega Pejë, janë të pabazuara dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara si në ankesë se ka mospërputhje të rezultateve të numrit të votave të publikuara me numrin real të votave të konfirmuara nga

dëshmitarët në teren, paneli nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pala ankuese pretendon me ankesën e saj. Kjo pasi që ankuesja nuk i ka bashkangjitur ankesës prova bindëse që mbështesin pretendimet e saj, ndërsa me provat që janë në shkresat e lëndës nuk është arritur të argumentohen pretendimet e saj se i mungojnë votat. Kështu që pretendimet e theksuara në ankesë tani për tani mbeten vetëm në suaza të dyshimit nga se nuk janë provuar me fakte dhe në prova relevante apo konkrete.

Me nenin 101 paragrafi 3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcaktohet se *“votat për kandidatët e subjekteve politike numërohen në qendrat komunale të numërimit të fletëvotimeve për kandidatë”*, ndërsa paragrafi 13 i këtij neni përcakton se: *“të dhënat dhe rezultatet për çdo vendvotim dërgohen për tabulim në QNR menjëherë pas përfundimit të punës së çdo ndërrimi. Kopjet e formularëve të rezultateve skanohen, publikohen dhe vendosen në vende të qasshme për vëzhguesit, si dhe ju ofrohen subjekteve politike dhe kandidateve, sipas kërkesës”*.

Rregulla Zgjedhore e KQZ-së Nr. 16/2024 Qendrat Komunale të Numërimit neni 18 paragrafi 1 përcakton se *“pas mbylljes së kutisë së votimit, rezultatet dhe formularët skanohen dhe publikohen në web faqen e KQZ-se, vendosen të qasshme në QKN për vëzhguesit dhe ju ofrohen subjekteve politike dhe kandidateve sipas kërkesës”*.

Bazuar në dispozitën e sipërcituara paneli ka gjetur se kandidatja në fjalë përkundër që ka pasur mundësi të informohet përmes QKN-së në Pejë si dhe përmes web faqes së KQZ-së për votat të cilat i ka të fituara, e njëjta në ankesën e saj nuk ka sqaruar se sa vota i ka në dispozicion gjegjësisht se sa vota i ka fituar dhe sa vota pretendon se i mungojnë, andaj pretendimet e saj ishin të përgjithësuara, të papërcaktuara, e që në fakt pretendimet e palës ankuese më shumë paraqiteshin si pritshmëri të saja për një numër më të madhe të votave.

Neni 105 paragrafi 1 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcaktohet se *“ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR dorëzohen në PZAP brenda 48 orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar”*.

Nisur nga ky fakt pala ankuese nuk e ka kontestuar administrimin dhe numërimin e fletëvotimeve të saj në QKN, por thekson se ka mospërputhje të rezultateve të numrit të votave të publikuara me numrin real të votave të konfirmuara asaj (kandidates) nga votuesit në teren- pra votat e premtuara, pa e specifikuar se cila është ajo mos përputhje e rezultateve të votave, pra e njëjta nuk e precizon në ankese se cili është numri i votave të publikuar nga KQZ-ja, dhe cili është numri i votave për të cilat pretendon se i mungojnë. Pra nga kjo rrjedhë paqartësia se cili është qëndrimi faktik dhe juridik i ankueses.

Neni 13 paragrafi 7 i Rregullores së PZAP-it Nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave parashih se : *“Paneli para se të vendos lidhur me ankesën mund të kryej hetime nëse e konsideron të nevojshme dhe të arsyeshme”*.

Neni 117 paragrafi 4 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcaktohet se *“PZAP-ja mund të urdhëroj rinumërimin e fletëvotimeve në një*

vendvotim apo qendër të votimit në një vendvotim apo qendër votimi si dhe shqyrtimin e materialit votues si pjesë të hetimeve për ankesën e parashtruar”.

Paneli duke u bazuar në nenin 105 dhe 117.4 të LZP-së paneli mund të urdhëroj rinumërimin e fletëvotimeve apo veprimet e tjera në rastet kur gjatë administrimit të numërimit të fletëvotimeve ka parregullsi, dhe mbi këtë bazë paneli do të mund të ndërmerre veprime hetimore apo të urdhëronte rinumërimin e fletëvotimeve, por në rastin konkret pala ankuese nuk e ka të qarte se cila është parregullsia gjegjësisht cili është numri i votave të kontestuar - të munguara e të cilat rezultate janë publikuar në vazhdimësi nga KQZ, në web faqen e saj e cila edhe ka bërë azhurnimin-përditësimin e tyre.

Sa i përket pretendimeve të palës ankuese që mbështeten në listimin e emrave të disa personave – votuesve, të identifikuar me emër dhe mbiemër, numër personal, nënshkrimin e tyre si dhe numër të telefonit të tyre, sipas vlerësimit të panelit është e pamjaftueshme si provë e vetme të vërtetoj pretendimin e saj për parregullsi, nga se listimi i disa emrave të personave të ndryshëm si votues të mundshëm të kandidates në fjalë, nuk mund të merret si dëshmi e vlefshme për të mbështetur pohimet e ankueses për parregullsi gjatë procesit zgjedhor. Paneli vlerëson se qëndron fakti se është e drejtë e votuesit që pas votimit të deklarohet lirshëm lidhur me votën e tij, apo që të interesohet për votën e tij, por mënyra se si ankuesja e ka përpiluar dëshminë me emrat e votuesve që kinse e kanë votuar, lista si e tillë nuk e përmbushë as kushtin formal dhe as atë përmbajtësor të konsiderohet provë bindëse për procedim dhe hetim të mëtutjeshëm apo për hapjen e kutive të votimit.

Po ashtu është e pa kontestuar se bazuar në nenin 4 paragrafi 1.3 të LZP, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara, gjë sa shpërfaqja e vullnetit të votuesve në parim cenon fshehtësinë votës.

Neni 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcakton se “*Liria dhe fshehtësia e votës është e garantuar. Askush nuk ka të drejtë të pengojë ndonjë qytetar për të votuar, të detyrojë atë në një mënyrë, të mbajë atë përgjegjës për votën, ose të kërkojë kundër dëshirës së tij/saj të zbuloj votën e tij/saj ose arsyet për mos votim*”

Duhet cekur se lidhur me deklaratat e votuesve dhe fshehtësisë së votimit, është krijuar tashmë praktika gjyqësore nga se Gjykata Supreme me Aktgjykimin e saj AA.nr.61/2025 të datës 24.03.2025 kishte konstatuar se: “*deklaratat e votuesve të cilët pretendojnë se kanë votuar një kandidat të caktuar nuk mund të merren si prova të bazuara për faktin se nuk mund të vërtetohet në asnjë formë se votuesit përkatës të kenë votuar për subjektin e caktuar dhe kandidatin e caktuar për shkak se fletëvotimi nuk mund të identifikohet me emrin e votuesit*”.

Paneli vlerëson se pretendimet e tilla janë të përgjithësuara, të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë, parashtruesja e ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj me prova konkrete, të ligjshme se ka pasur mungesë të votave, por se pretendimet e ankueses janë më shumë pritshmëri e saj për më shumë vota, e jo që në realitet ka pasur mungesë të votave.

Paneli, vlerësoi se ankesa është e pabazuar dhe e pa argumentuar, pasi që parashtuesja e ankesës nuk ka bashkangjitur prova bindëse, apo ndonjë dëshmi, formularët e rezultateve të subjekteve politike dhe të kandidatëve, librin e votimit, deklaratat e KVV apo dokumente të tjera, me te cilën do te vërtetoheshin këto pretendime, andaj nuk mund të vërtetohej se ka shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së. Andaj neni 117 paragrafi 3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcakton se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtuesja e ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.273-2/2025 datë 30.10.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.